



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-022
Prishtinë, më 19 maj 2015, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

IMBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 19 MAJ 2015

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Aida Dërguti, Slobodan Petroviq dhe Duda Balje, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Glauk Konjufca, Donika Kadaj-Bujupi, Sasha Milosavljeviq, Haxhi Shala dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Blerim Latifi;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohet edhe një (1) pikë shtesë, të cilën e miratoi Kryesia e Kuvendit.

Më pas, Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 12 dhe 13 maj 2015,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe kërkesave.

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 12 dhe 13 maj 2015

Kryesia i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 12 dhe 13 maj 2015.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryetari fillimisht i njoftoi anëtarët e Kryesisë lidhur me rekomandimin e Komisionit të Posaçëm për zgjedhjen e dy (2) gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe tha se kjo pikë i plotëson kushtet formale për procedim në Seancë plenare.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me rekomandimin e Komisionit të posaçëm për zgjedhjen e dy (2) gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, këtë pikë e shtyu për seancën plenare të radhës.

Kryetari, gjithashtu i njoftoi anëtarët e Kryesisë se gjatë kësaj jave komisionet parlamentare i kanë në procedurën e shqyrtimit 9 projektligje, që kanë të bëjnë me procesin e liberalizimit të vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës dhe të cilat duhet të procedohen për shqyrtim të dytë për seancën plenare më 28 maj 2015.

Kryesia, me propozimin e kryetarit të Kuvendit, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare e radhës të mbahet më 21 maj 2015, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. *Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
2. *Koha për pyetje parlamentare,*
3. *Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mëparshme,*
4. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat personale,*
5. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave,*
6. *Shqyrtimi i Raportit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2014,*
7. *Shqyrtimi i Raportit të Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2014.*

Kryetarja e Grupit Parlamentar të AAK-së, Donika Kada,-Bujupi, e shtroi çështjen e procedimit të Projektligjit për Forcat e Armatosura të Kosovës nga Qeveria e Kosovës.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me procedimin e akteve juridike për formimin e Forcave të Armatosura të Kosovës, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të përgatisë një informatë lidhur me procedimin në Kuvend të propozim-amendamenteve Kushtetuese dhe të Projektligjit për formimin e Forcave të Armatosura të Kosovës.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe kërkesave

1. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtarë në Letoni

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i anëtarëve të Komisionit për Integritet Evropian, në këtë përbërje: Xhavit Haliti dhe Valdete Bajrami, si dhe nga stafi mbështetës i Komisionit, Florent Mehmeti, në Letoni, prej datës 30 maj deri më 3 qershor 2015.

2. Të gjitha shpenzimet për realizimin e këtij udhëtimi për të lartshënuarit në pikën 1 (një) të këtij vendimi, mbulohen nga buxheti i Kuvendit.

Më pas, kryetari i Kuvendit deklaroi se tani e tutje lidhur me kërkesat për udhëtime zyrtare jashtë vendit për delegacionet dhe për deputetët e Kuvendit do të vendosë Kryesia e Kuvendit, konform nenit 15.10 të Rregullores së Kuvendit.

2. Njoftimi me shkresat mbështetëse për Republikën e Kosovës, nga Grupi i Miqësisë Francë-Kosovë, në Asamblenë Nacionale të Francës, drejtuar disa institucioneve të Francës

Kryesia u njoftua se Grupi i Miqësisë Francë-Kosovë, në Asamblenë Nacionale të Francës, me shkresa zyrtare u është drejtuar disa institucioneve të Francës, nëpërmjet të cilave është kërkuar mbështetje për Republikën e Kosovës në disa fusha, e në veçanti për çështjen e liberalizimit të vizave dhe anëtarësimin në Këshillin e Evropës.

Nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti, i njoftoi anëtarët e Kryesisë lidhur me takimin që ai kishte zhvilluar me z. Ryke në Strasburg. Ai tha se z. Ryke ka dhënë informata plotësuese për institucionet, si Asamblenë Nacionale, kryetaren e Komisionit të Jashtëm të Parlamentit dhe ministrit të Jashtëm.

Diskutimi i plotë i nënkryetarit të Kuvendit, z. Sabri Hamiti është dhen i plotë në transkript.

3. Njoftimi lidhur me vizitat zyrtare të realizuara jashtë vendit nga disa komisione parlamentare dhe deputetë

Kryesia u njoftua nga Komisioni për Punë të Jashtme për vizitën zyrtare të realizuar në Çeki, më 28 prill 2015; nga Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës, për vizitën zyrtare të realizuar në Mal të Zi, prej 28-29

për pjesëmarrjen e tyre në Seminarin Rose-Roth të Asamblesë Parlamentare të NATO-s, i cili është mbajtur, në Beograd, më 31 mars deri më 2 prill 2015.

Kryetari i mbylli punimet e mbledhjes së Kryesisë në orën 12:15 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale